REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**

**KESHILLI BASHKIA**

Nr 2583/15 prot. B.Curri, më 4 .7 . 2022

**VENDIM**

**Nr 49 Datë 30. 06. 2022**

**PËR DISA NDRYSHIME TË NATYRËS INFRASTRUKTURORE NË SHESHIN "AZEM HAJDARI", TË QYTETIT BAJRAM CURRI.**

Këshilli i Bashkisë Tropojë, ne mbledhjen e tije te dates 30.06. 2022 me propozim te Kryetarit te bashkisë, ne mbeshtetje te nenit 8, te nenit 9 pika 1/1 shkronja "b", pika 1/3 shkronja "a", të nenit 23 pika 4 dhe pika 14, 55 pika 6 te Ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 per "Veteqeverisjen Vendore", i ndryshuar; të Ligjit nr. 44/2015, date 30.04. 2015 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikës se Shqiperise", i ndyshuar; shkresës "Kërkesë" nr.2514 prot., date 3.6.2022; Të ligjit Nr.9936 datë 28.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit të buxhetit ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të VKM-së Nr. 397 datë 1.6.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtëtërore që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Bajram Curri, të Qarkut Kukës"; të Kontratës Nr.14, datë 8.11.2016 me nr.4079 prot., datë 8.11.2016 "Rikualifikim urban i sheshit "Azem Hajdari"; Kontratës Nr.15, datë 5.1.2018 me nr.78 prot., datë 5.1.2018 "Rikualifikim urban i sheshit "Azem Hajdari faza II-të";

**VENDOSI**

1). Miratimin e ndryshimeve të natyrës infrastrukturore në sheshin "Azem Hajdari", të qytetit të Bajram Currit, për efekt të përmirësimit të levizjes së këmbësorëve dhe automjeteve në këtë shesh, sipas projektit bashkangjitur hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, ne Bashkia Tropojë (ngushtim të sheshit me 3 pllaka).

2) .Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Sherbimeve.

3).Ky vendim hyn ne fuqi sipas pikes 6, nenit 55 te Ligjit nr. 139/215 "Për Veteqeverisjen Vendore".

Për Këshillin Bashkiak Tropojë

Sekretar
Ergent Gjongecaj

Kryetar
Shotë Bashaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI BASHKIA TROPOJE

Shpallur me 04.07.2022
Miratuar me 15 vota
Vota Pro 15
Vota Kunder 1
Vota Abstenim 0